



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 tetor 2020
Nr. ref.: RK1626/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/20

Parashtrues

Kujtim Bakija

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 283/2019,
të 9 tetorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kujtim Bakija, me vendbanim në Gjakovë, të cilin e përfaqëson Avdi Rizvanolli, avokat nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [Rev. nr. 283/2019] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 9 tetorit 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur e ka pranuar më 18 nëntor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 mars 2020, parashtruesi përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 2 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 7 korrik 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjakovë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzonin në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
10. Më 14 korrik 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
11. Më 16 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në Kompaninë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike (në tekstin e mëtejshëm: KEDS), në pozitën Elektracist i Matjes në Divizionin e Rrjetit, Distrikti në Gjakovë.
13. Më 2 shkurt 2015, KEDS, respektivisht Drejtori i Distriktit në Gjakovë, përmes Vendimit [nr. 214], i kishte shqiptuar parashtruesit të kërkesës masën disiplinore “*shkëputje të marrëdhënies së punës*”, për shkak të shkeljeve disiplinore, pasi kishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës së bashku me një punëtor tjetër të KEDS-it, me veprimet e tyre, kishin kontribuar në fshehjen-humbjen e borxhit të disa konsumatorëve.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë kundër vendimit të lartpërmendur në shkallë të dytë pranë KEDS-it, respektivisht tek Drejtori Ekzekutiv i Divizionit të rrjetit në Prishtinë.
15. Më 4 mars 2015, Drejtori Ekzekutiv i Divizionit të rrjetit në Prishtinë, përmes Vendimit me [nr. 1730], refuzoi kërkesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Vendimin [214], e Drejtorit të Distriktit në Gjakovë, të 2 shkurtit 2015.
16. Më 13 maj 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke kërkuar anulimin e dy vendimeve të lartpërmendura të KEDS-it, duke pretenduar se parashtruesit të kërkesës nuk i është dorëzuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore si dhe nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme për mbrojtje. Parashtruesi i kërkesës përmes padisë kërkoi kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave nga 1 shkurti 2015 e deri më 30 gusht 2016.
17. Më 29 gusht 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktgjykimin [C. nr. 100/2015], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi si të pabazuar, duke refuzuar padinë e parashtruesit kundër vendimeve të lartpërmendura të KEDS-it, si dhe kërkesën për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Gjykata Themelore në Gjakovë përmes aktgjykimit të saj konsideroi se veprimet e KEDS-it me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës kanë qenë të drejta dhe se nuk ka pasur parregullsi dhe shkelje ligjore dhe se, masa disiplinore e shqiptuar është bërë konform nenit 70 të Ligjit të Punës të Kosovës.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 17 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4459/2016], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 100/2015], e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj ishte përgjigjur në të gjitha pretendimet e parashtruesit.
20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Apelit, duke

pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 9 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 283/2019], refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme, ndër të tjera, kishte arsyetuar se “*gjykata e shkallës së dytë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale [...] Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
23. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se gjykatat e rregullta nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke mos i adresuar pretendimet e parashtruesit si dhe nuk e kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
24. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon se “*KEDS sh.a. duke shfrytëzuar pozitën e saj si punëdhënëse ka prezantuar prova të cilat ajo vet i ka përpiluar, ndërsa si dëshmitarë gjykata ka proceduar të gjithë punëtorët e KEDS sh.a. për çka të njëjtit nuk kanë qenë objektiv dhe si rezultat kanë sjellë në pabarazi palët në procedurë*”.
25. Parashtruesi i kërkesës, lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, thekson se i ky i fundit është i paarsyetuar, duke shtuar se “*Si është e mundur që një personi t’i ndërpritet marrëdhënia e punës me arsyetim aq të dobët*”. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu edhe për Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe vendimin e kontestuar pretendon se nuk janë të arsyetuar duke shtuar se ato vetëm shkurtimisht kanë vërtetuar vendimin e shkallës së parë, duke mos u dhënë arsye të mjaftueshme për pretendimet e parashtruesit.
26. Parashtruesi më tej thekson se “*Gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e ligjshmërisë duke u thirrur në shkelje disiplinore kinse të parapara me aktet e punëdhënësit. Shkeljet disiplinore duhet të parashihen vetëm me ligj dhe marrëdhënia e punës duhet të bëhet vetëm për arsye të parapara me ligj*”.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizon vendimin e kontestuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

31. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 283/2019] e 9 tetorit 2019, të Gjykatës Supreme pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
32. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara

në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktgjykimin [C. nr. 100/2015], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi si të pabazuar, duke refuzuar padinë e parashtruesit kundër vendimeve të KEDS-it përmes të cilave parashtruesit i ishte shqiptuar masa disiplinore *“shkëputje e marrëdhënies së punës”*, si dhe kërkesën për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Pas ankesës së parashtruesit, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit, duke e vërtetuar Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Gjykata Supreme kishte refuzuar revizionin e parashtruesit si të pabazuar, kundër vendimit të shkallës së dytë.
34. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 54 të Kushtetutës.
35. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se në substancë, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij gjykatat e rregullta nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke mos i adresuar pretendimet e parashtruesit si dhe nuk e kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dëshmitarët (të cilët kanë qenë punëtorë në KEDS) në rastin konkret nuk kanë qenë objektiv dhe se krejt kjo ka ndikuar në pabarazi për palët në procedurë. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkeljet disiplinore duhet të parashihen vetëm me Ligj dhe se gjykatat e rregullta janë thirrur në shkelje disiplinore të parapara me aktet e brendshme të KEDS-it.
36. Gjykata vëren se të njëjtat pretendime parashtruesi i kërkesës i kishte paraqitur edhe para gjykatave të rregullta.
37. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës arsyetoi se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [Ac. nr. 4459/2016] e 17 majit 2019, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka konstatuar se ankesa e parashtruesit është e pabazuar. Gjykata Supreme kishte konstatuar se Gjykata e Apelit kishte dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante, në të cilat e kishte mbështetur aktgjykimin e saj.
38. Më saktësisht, Gjykata e Supreme në Aktgjykimin [Rev. nr. 283/2019] e 9 tetorit 2019, lidhur me pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe të cilat parashtruesi i kërkesës i ngrit edhe në Gjykatë, kishte theksuar:

“Të papranueshme cilësohen thëniet në revizion se gjykata e instancës më të ulët gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se vendimi i të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës së paditësit është i ligjshëm. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate procedura disiplinore ndaj paditësit është

filluar dhe zhvilluar në bazë të nenit 8 dhe 10 të Kodit Disiplinor të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS). Vendimi kontestues mbi shkëputjen e kontratës së punës së paditësit është marrë në pajtim me dispozitën e nenit 70 paragrafi 1.4.1 të Ligjit të punës të Kosovës, me të cilën dispozitë është paraparë se: "punëdhënësi mund t'ia ndërpres kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit". Veprimet e paditësit drejtë janë kualifikuar si shkelje të rëndë të detyrave të punës nga neni 7.1 pika h)dhe r) të Kodit Disiplinor të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), ku në pika (h) si shkelje e rëndë është paraparë" përdorimi nga punëmarrësi i pozitës së tij/saj, apo tejkalimi i kufizimeve të autorizimit të tij/saj me qëllim të sigurimit të përfitimit joligjor material për vete apo ndonjë person tjetër apo ndonjë organizate biznesore apo për të shkaktuar ndonjë dëm te personat tjerë organizatat biznesore". Me pikën r) si shkelje e rëndë po ashtu është paraparë" mos deklarimi i qëllimshëm, apo fshehja e informatave në lidhje ' me ndonjë shkelje serioze apo të lehtë, duke përfshirë shkujdesin e tepruar, që është si pasojë e neglizhencë".

39. Në dritën e krejt kësaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin [Rev. nr. 283/2019] e 9 tetorit 2019, të Gjykatës Supreme me të cilin është refuzuar revizioni i parashtresit, është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës Supreme dhe gjykatave të instancave më të ulëta, nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI70/11, parashtresë të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
41. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtresë i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
42. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtresë i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme dhe ato të instancave më të ulëta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të

mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës: *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

43. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimit të kontestuar apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
44. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
45. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi